



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.26, datë 21. 04. 2021

“PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR MIRATIMIN E MUNDËSISË SË SHFRYTEZIMIT PËR SIGURIMIN E DRUVE TË ZJARRIT PËR NGROHJE PËR KOMUNITETIN E BASHKISË SKRAPAR, DHE SASISËNË E MUNDËSHME TË BIMËVE MJEKSORE ETEROVAJORE PËR VITIN 2021”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 21.04.2021, pasi mori në shqyrtim projektaktin e paraqitur nga Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor, hartuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, gërma e, Ligjin Nr. 57/2020, “Për pyjet”, VKM- në Nr. 433, datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/ Bashkive”, VKM- në Nr.438, datë 08.06.2016, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, pika nr. 26, dhe në Udhezimin Nr. 2 datë 03.03.2017 “Per kerkesat teknike te caktimit te ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese, rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje ”

V ENDOSI :

1. Miratimin e mundësisë së shfrytëzimit për sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje për komunitetin e bashkisë Skrapar.
2. Miratimin e sasisë së mundshme të bimeve mjeksore eterovajore në fondin pyjor/kullosor të planifikuara për tu vjelë nga banorët e grumbulluar nga subjektet për vitin 2021.

Vendimi u miratua me: 9 - vota pro , vota kundër – s’ka, vota abstenim- s’ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARI KËSHILLIT
Edlira SHKËMBI